



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:050708
Datë: 29.03.2022
Numri i dokumentit: 02853946

C. nr. 971/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil përmes gjyqtarit Venhar Salihu, në çështjen kontestimore të paditësit B.B nga Gjilani, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Mustafë Nuhiu nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit– Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj me autorizim B.M., jurist nga Gjilani, me objekt kontesti, kompensim të shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 823.50€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të datës 07.03.2022, jashtë seance më dt. 15.03.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.B kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe **DETYROHET** e paditura, që paditësit t’i paguajë në emër të shpërblimit jubilar shumë prej 229.50€ si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, t’ia paguajë shumë prej 594.00€, respektivisht shumë përgjithshme të të hollave në lartësi prej 823.50€, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit B.B t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 270.00€.

A r s y e t i m i

Paditësi më dt. 10.04.2020 në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt të kontestit, kompensim të shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, kurse më dt. 25.02.2022, në këtë gjykatë ka dorëzuar parashtrësën për ndryshimin objektiv të kërkesëpadiës, ku nga gjykata ka kërkuar që të obligohet e paditura, që paditësit për mbi 10 vite të përvojës së punës, t’i paguajë vlerën prej 50% të një page bazë, pra shumë prej 229.50€, si dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për 297 ditë, ku për çdo ditë nga 2.00€, t’i paguajë shumë prej 594.00€, respektivisht shumë e përgjithshme për të gjitha kërkesat

në lartësi prej 823.50€ me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Në përgjigjen në padi, e paditura në tërësi e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadiës, duke pretenduar se në lidhje me këtë çështje kompetente nuk është Gjykata Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil në Gjilan, por është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, se Kontrata Kolektive e lidhur ndërmjet MASHT-it dhe SBASHK-ut, për Komunën e Gjilanit kjo kontratë kolektive, nuk krijon obligime pasi që Komuna e zhvillon aktivitetin e saj në bazë të LVL-së, se kontrata kolektive nuk mund të ketë të drejta më të favorshme për palët që kanë nënshkruar sesa Ligji i Punës, poashtu paditësi punon me orar jo të plotë të punës. Gjithashtu kërkesa e paditësit për shpërblim jubilar, ka arritur afatin e parashkrimit, andaj të drejtat e tilla nuk mund t'i takojnë. Për këto arsye ka kërkuar nga gjykata, që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata, në lidhje me këtë çështje më dt. 07.03.2022, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor, ku për shkak të pandërlikueshmërisë së çështjes, gjykata në bazë të nenit 401 të LPK-së, nuk ka konvokuar seancë përgatitore, por ka vazhduar me shqyrtimin kryesor të çështjes.

Kërkesat e Palëve

Paditësi, përkatësisht përfaqësuesi i tij, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 07.03.2022 dhe në shpjegimet përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe ndryshimit objektiv të kërkesëpadiës të bërë më dt. 25.02.2022. Në shpjegimet përfundimtare, ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të aprovohet si e bazuar dhe shpenzimet procedurale në vlerë prej 270.00€, në të cilat përfshihen: për taksë gjyqësore shumë prej 31.00€, për përpilimin e padisë shumë prej 104.00€ dhe për përfaqësim në një seancë shumë prej 135.00€.

Përfaqësuesi i të paditurës, si në shqyrtimin kryesor të dt. 07.03.2022 dhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi, duke kundërshtuar padinë, ngase e paditura nuk është nënshkruese e akteve nënligjore, mbi të cilat paditësi kërkon të drejtën e vet. Kurse, sa i përket shpenzimeve të procedurës, ka kërkuar nga gjykata që të veprojë në bazë të nenit 453.1 të LPK-së.

Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 07.03.2022, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar se për palët ndërgjyqëse nuk janë kontestuese këto faktet: Paditësi është në marrëdhënie të punës tek e paditura, përkatësisht në SH.M.E. "M. B." në Gjilan. Paditësi ka 15 vite të përvojës së punës, kurse paga bazë e paditësit është 459.00€, për palët ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese edhe faktet se paditësja nga viti 2017 deri në vitin 2021, ka realizuar gjithsej 297 ditë të punës, si dhe fakti se në shkollën ku punon paditësi, nuk ka shërbime të kuzhinës, gjithashtu nuk kanë të angazhuar ndonjë lloj furnizimi të ushqimeve në këtë shkollë.

Për shkak që faktet e lartëcekura nuk kanë qenë kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, gjykata nuk ka administruar provat materiale për vërtetimin e këtyre.

Vendimi i gjykatës

Nga gjendja faktike e shpjeguar si më lart dhe bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017 dhe e dt. 22.01.2021, gjykata vërteton se kërkesa e paditësit gjënë bazë në nenin 35, paragrafi 8, nën-paragrafi 8.1, ku paditësja për mbi 10 vite të përvojës së punës, ka të drejtë të kompensohet në vlerë prej 50% të një page bazë, e që në rastin konkret i bie që për përvojën e punës së tij prej 15 vite, ka të drejtë në shpërblim prej 229.50€ nga e paditura (pasi që u vërtetua se paga bazë është 459.00€). Gjithashtu në nenin 35, paragrafi 8, nën-paragrafi 8.5 theksohet se pagesën për shpërblim jubilar, duhet ta realizojë punëdhënësi kur plotësohen kushtet për një gjë të tillë, e që në rastin konkret punëdhënësi është Komuna e Gjilanit.

Gjykata vërteton se duke u bazuar në nenin 35, paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017 dhe asaj të dt. 22.01.2021, kërkesa e paditësit në lidhje me shpërblimin e ushqimisë ka bazë juridike, andaj Komuna e Gjilanit, obligohet që për 297 ditë të punës së paditësi që ka realizuar nga dt. 18.04.2017-20.01.2021, për çdo ditë t'ia kompensojë nga 2€, e që në total i bie shuma prej 594.00€ në emër të ushqimisë.

Prandaj, për këto arsye vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, që ta detyrojë të paditurën si palë humbëse në këtë proces gjyqësor që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në vlerë prej 270.00€, ku në emër të taksës gjyqësore shumë prej 31€, në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 104€, si dhe në emër të përfaqësimit në një seancë gjyqësore shumë prej 135€.

Për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Kontratën Kolektive, ku në nenin 2 të kësaj kontrate është paraparë se dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjitha punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e Institucioneve të Arsimit të Lartë, MASHT-in etj.) pra në tërë territorin e RKS-së, duke përfshirë edhe institucionet publike, por edhe ato private. Gjithashtu, në nenin 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës me nr. 03/L-068, janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës.

Pretendimi i të paditurës në lidhje me atë se paditësi ka realizuar ditë të punës gjoja se pas dt. 18.04.2020, domethënë pas skadimit të afatit të Kontratës, nuk është i qëndrueshëm, pasi që tani kemi në fuqi kontratën e re kolektive të arsimit (e cila është vazhdim e Kontratës Kolektive të mëparshme), e nënshkruar me dt. 22.01.2021.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës sa i përket shpërblimit jubilar, gjykata një pretendim të tillë e konsideron të pa bazë, me arsyetimin se paditësi ka arritur një përvojë të punës prej mbi 15 viteve dhe se ende vazhdon të realizojë aktivitetin punues në kuadër të SH.M.E “M. B.”. Andaj duke pasur parasysh se Kontrata Kolektive e Arsimit ka hyrë në fuqi më dt. 18.04.2017, kurse paditësja padinë e ka paraqitur më dt. 10.04.2020, pra brenda afatit kohorë të paraparë me ligj, përkatësisht në nenin 87 të Ligjit të Punës i cili në mënyrë shprehimore ka paraparë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”, pra nga kjo shohim se nuk kanë kaluar tri vite nga momenti i hyrjes në fuqi, e deri në paraqitjen e padisë.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C. nr. 971/20, dt. 15.03.2022

Gjyqtari,
Venhar Salihu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.